

ÖBAG


Kërkesat për drejtimin e
brendshëm dhe raportimin ligjor
të Holding Shtetëror Austriak

ÖBAG
ÖSTERREICHISCHE
BETEILIGUNGS AG



Drejtimi i brendshëm në ÖBAG


Strategjia e përgjithshme e ÖBAG-un mbështetet në ligjin për ÖIAG-un



* Krahas ÖBAG, Ministria Federale e Financave zotëron aksione në disa njësi ekonomike të tilla si Banka Kombëtare e Austrisë (ÖNB), ÖBFA, BBG dhe BRZ. Qeveria zotëron aksione edhe në shoqëri të ndërtimit të rrugëve dhe NSH të tjera, ÖBB (hekurudha), ÖBF (pyjet), ASFINAG (autostradat) dhe ORF (radiotelevizioni) për të cilat të drejtat e pronësisë i ushtrojnë ministri të tjera. Pra, megjithëse ÖBAG është pjesëmarrja më e madhe, ka NSH të tjera të pavarura në nivel federal në Austri.

Historiku i shoqërisë holding të Austrisë







Nga një mjet privatizimi në një administrim aktiv të investimeve




Portofoli i ÖBAG

Shoqëritë kryesore austriake me vepra infrastrukturore strategjike

Portofoli i ÖBAG, përfshirë 5 shoqëri të listuara dhe 5 shoqëri jo të listuara¹

 <ul style="list-style-type: none"> Shërbim postar 	<ul style="list-style-type: none"> Xhiro 2,7 miliardë € 27.300 punonjës 2 miliardë € tavan tregu 	52.9%	 BIG <ul style="list-style-type: none"> Pasuri të paluajtshme 	<ul style="list-style-type: none"> Xhiro 1,4 miliardë € 1.100 punonjës 	100%
Verbund <ul style="list-style-type: none"> Ndërmarrjet komunale 	<ul style="list-style-type: none"> Xhiro 10,4 miliardë € 3.800 punonjës 26,8 miliardë € tavan tregu 	51%³	CASINOS AUSTRIA <ul style="list-style-type: none"> Kazino & lotari 	<ul style="list-style-type: none"> Xhiro 1,5 miliardë € 3.100 punonjës 	33.2%
 OMV <ul style="list-style-type: none"> Energjia & kimiket 	<ul style="list-style-type: none"> Xhiro 39,5 miliardë € 20.600 punonjës 12,9 miliardë € tavan tregu 	31.5%	 APK PENSIONS KASSE <ul style="list-style-type: none"> Fond pensioni 	<ul style="list-style-type: none"> 7,4 miliardë € aktive të investuara 100 punonjës 	33.0%
 A1 <ul style="list-style-type: none"> Shërbimi i komunikacionit 	<ul style="list-style-type: none"> Xhiro 5,3 miliardë € 17.500 punonjës 5,9 miliardë € tavan tregu 	28.4%	 EuroTeleSites <ul style="list-style-type: none"> Kullat e telekomunikacionit 	<ul style="list-style-type: none"> Xhiro 232 milionë € 165 punonjës 0,7 miliardë € tavan tregu 	28.4%

Ndikimi i shoqërive të ÖBAG²



¹Shifrat e shoqërive, tavanit i tregut dhe vlera e portofolit më 31.8.2024; ÖBAG zotëron dy investime të tjera në portofol: GKB dhe IMIB

²sipas studimit në Economica në 2023, dividendët në 2024; Ponderimi ATX më 31.12.2023

³ÖBAG administron pjesëmarrjen e shumicës në Verbund në emër të Ministrisë Austriake të Financave. ⁴Proforma 2022 publikuar në prospekt.

Strategjia e ÖBAG

Si pronar i besueshëm dhe i pavarur, jemi të angazhuar për ruajtjen dhe rritjen e vlerës

Vizioni

Misioni

Rritja afatgjatë e vlerës së shoqërive të portofolit

Rritje e qëndrueshme e aktiveve shtetërore

Fuqizimi i Austrisë si nyje biznesi dhe kërkimi shkencor

Qasja

- Kryeqendër
- Krijim afatgjatë i vlerës
- Modernizim & transformim

- Standarde të forta MSQ
- Bashkinvestitor i besueshëm
- Vlerë portofoli në rritje

- Rëndësia për vendndodhjen e biznesit si faktor kritik
- Infrastruktura kritike, siguria e furnizimit




Ambicia e ÖBAG

Objektivat e qartë dhe vlerat qendrore solide na sigurojnë kuadrin brenda të cilit veprojmë



Pjesëmarrje e pavarur e investimeve

ÖBAG administron dhjetë shoqëri, disa prej të cilave zotërohen pjesërisht ose tërësisht nga Republika e Austrisë.



Fuqizimi i ekosistemit tregtar

Si investitor i besueshëm dhe afatgjatë, ÖBAG është i angazhuar për administrim dhe investim të qëndrueshëm.



Ruajtja & rritja e vlerës

Fokusi i ÖBAG është te rritja rentabël dhe e qëndrueshme e shoqërive të portofolit.



Administrim i pavarur i portofolit

Përmes emërimit të ekspertëve me përvojë në këshillat mbikëqyrës të shoqërive të portofolit, ÖBAG kontribuon në vendosjen e prioriteteve strategjike.



Qeverisje më e mirë

ÖBAG mbron idenë e një drejtimi të brendshëm dhe administrimi më të përgjegjshëm të shoqërive nëpërmjet ngritjes së sistemeve transparente të raportimit si edhe minimizimit efekti të rreziqeve dhe sistemeve të kontrollit.



Qëndrueshmëria


ÖBAG mbështet dhe promovon qëndrueshmërinë ekologjike, shoqërore dhe tregtare në shoqëritë e portofolit.



MSQ @ ÖBAG

Monitorimi e TKP-ve për MSQ-në në mbarë portofolin

Informacion i përgjithshëm



Informacion i përgjithshëm

- Sistemi i monitorimit të portofolit është ngritur në fund të 2020 dhe prej atëherë është përmirësuar dhe zgjeruar vazhdimisht.
- Ai siguron analizë në thellësi të një game të gjerë TKP-sh lidhur me temat e mjedisit (M), sociale (S) dhe të qeverisjes (Q).



Synimi

- Të merren informacione për ecurinë e qëndrueshmërisë së shoqërive të portofolit në krahasim me shoqëri të ngjashme dhe me shoqëritë e tjera të portofolit
- Të identifikohen faktorët e qëndrueshmërisë që ia rritin vlerën portofolit




Temat




- Çlirimet e gazit të dyoksidit të karbonit
- Konsumi i energjisë
- Mbetjet & riciklimi
- Përvoja e punonjësve
- Diversiteti
- Pagë e barabartë
- Këshilli i Administrimit
- Taksonomia e BE-së

Korniza MSQ e ÖBAG: Vënia e theksit te analiza sasiore dhe angazhimi i këshillave të mbikëqyrjes

Model zbatimi me tre hapa për monitorimin MSQ



Informacione kyçe nga monitorimi i MSQ-së në mbarë portofolin

- 
 - 2023: Përditësimi i analizës (p.sh. TKP të rinj, përshtatja e grupit të shoqërive të ngjashme)
 - Identifikimi i mundësive dhe pengesave
 - Nxjerrja e konstatimeve për punën e komiteteve dhe për kriteret e pagës
- 
 - Diskutimi me shoqëritë e portofolit, anëtarë të përzgjedhur të këshillave mbikëqyr, ekspertë dhe OJQ për analizat e TKP-ve të MSQ-së për mbarë portofolin
 - Zhvillimi i vazhdueshëm i sistemit të monitorimit të MSQ-së
- 
 - Përfshirja e informacioneve në punën e këshillave mbikëqyrës dhe komiteteve të kontrollit të shoqërive të portofolit
 - Hartimi i përbashkët i strategjive për MSQ-në
 - Përcaktimi i objektivave MSQ dhe integrimi i tyre në shpërblimin e administratorëve të shoqërive të portofolit



Kërkesat ligjore për raportimin e NSH-ve si njësi ekonomike
pronare

Informacion i përgjithshëm

- **Të drejtat për informim të mbledhjes vjetore të asamblesë së përgjithshme** në përputhje me ligjin për shoqëritë aksionare të përfaqësuar nga Ministria e Financave; Mbledhja vjetore e asamblesë së përgjithshme drejtohet nga kryetari i këshillit mbikëqyrës në praninë e këshillit të administrimit.
- Krahas ligjit për shoqëritë aksionare, **neni 6, pika 4 ÖIAG-G parashikon për të drejtë të veçantë ligjore për informim të Ministrit Federal të Financave** në lidhje me ÖBAG.
- Po kështu, këshillit të administrimit i kërkohet, në përputhje me dispozitat e ligjit për shoqëritë aksionare dhe bursat, të raportojnë pranë Ministrit Federal të Financave
 - **në çdo moment për të gjitha çështjet dhe vendimet** e ÖBAG,
 - për të vënë **në dispozicion të gjitha informacionet** Ministrit Federal të Financave menjëherë kur ky i kërkon dhe
 - për të paraqitur një **raport tremujor me shkrim për të gjitha çështjet materiale në lidhje me ÖBAG** si edhe për administrimin e investimeve sipas neneve 7 dhe 7a.
- Krahas këtyre, ÖBAG **raporton me shkrim një herë në vit pranë qeverisë federale për të gjitha çështjet dhe vendimet e rëndësishme të ÖBAG** në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga ligji për shoqëritë aksionare dhe bursat.

Përmbajtja e dhënë në p. 1

- Në bazë të kësaj dispozite dhe standardeve të tjera lidhur me raportimin, ÖBAG raporton rregullisht dhe plotësisht pranë Ministrisë Federale të Financave, si vijon:
 - **Raporti tremujor sipas nenit 6, pika 4, të Ligjit ÖIAG.** Raporti tremujor përqendrohet te këto pika kryesore:
 - Ngjarjet e rëndësishme pas përfundimit të periudhës së raportimit
 - Zhvillimi i biznesit të ÖBAG
 - Raport mbi mbajtjen e rreziqeve në kontroll
 - Informacion i përgjithshëm për pjesëmarrjet
 - Informacion i hollësishëm për pjesëmarrjet e rëndësishme
 - **Raporti i kontrollit në përputhje me nenin 67 të BHG.** Edhe ky raport dorëzohet çdo tremujor. Raportet e tremujorit I dhe tremujorit III i vihen në dispozicion edhe parlamentit.
 - Informacion i përgjithshëm për shifrat kryesore
 - Parashikime dhe analiza të shmangies për periudhën përkatëse
 - Raport mbi mbajtjen e rreziqeve në kontroll
 - Informacion i përgjithshëm i organeve drejtuese, informacion i përgjithshëm për portofolin
 - **Raporti i kontrollit dikasterial.** Mbështetur në praktikën e mëparshme të shoqërisë pararendëse të ÖBAG, një raport shtesë në format xls me këtë përmbajtje:
 - Shifra vjetore të pjesëmarrjeve madhore
 - Komente mbi shmangiet

Përmbajtja e dhënë në p. 2

- **Raporti i administratorëve Verbund.** Në përputhje me marrëveshjen e administrimit Verbund midis Ministrisë Federale të Financave dhe ÖBAG, çdo tremujor përstatitet një raport më vete për administrimin e investimeve të jashtme të Verbund AG në përputhje me nenin 7a të ligjit ÖIAG. Temat kryesore të raportit përkojnë me ato të raportit tremujor. Gjithashtu, raporton për çështjet kontabël.
- **Raporti vjetor sipas nenit 6, pika 4, të Ligjit ÖIAG.** Ky raport i dorëzohet çdo vit qeverisë federale dhe mbulon këto tema:
 - Ngjarjet e rëndësishme gjatë periudhës së raportimit
 - Zhvillimi i biznesit të ÖBAG
 - Informacion i përgjithshëm për pjesëmarrjet
 - Informacion i hollësishëm për pjesëmarrjet madhore
 - Parashikimet për vitin e ardhshëm
 - Organet drejtuese të ÖBAG
- **Raporti për masat në përputhje me njoftimin e Ministrit Federal të Financave në bazë të ligjit IAG 2000 datë 25 korrik 2019.** Raport vjetor për ecurinë e përdorimit të fondeve i dorëzohet Degës I/5 në përputhje me njoftimin e lartpërmendur. Ky raport gjithashtu auditohet nga audituesi.